



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Ministria e Drejtësisë shpall konkursin e hapur për Burgun e Shkodrës

2017-11-13 20:42:00



Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, "Për policinë e burgjeve", të ndryshuar, Kodit të Punës, i ndryshuar, si dhe Urdhërin nr. 6783, datë 13/11/2017 "Për miratimin e kriteve të posaçme për pozicionet e punës në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale", me qëllim rekrutimin e punonjësve për të gjitha pozicionet në Burgun e Shkodrës, bazuar në procedurë transparente të konkurrimit publik, dhe kriteret që mbështesin parimin e meritokracisë,

Ministria e Drejtësisë shpall konkursin e hapur për Burgun e Shkodrës për pozicionet e mëposhtme:

STAF POLICOR

Punonjës të Rolit të Mesëm

15 pozicione

Punonjës të Rolit Bazë

327 pozicione

Kandidatët për pozicionin e Punonjës me Status Polici në "Policinë e Burgjeve" duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme si vijon si dhe kriteret e posaçme të parashikuara në Urdhërin nr. 6783 datë 13/11/2017 bashkëlidhur:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht, për të kryer detyrën;
- Të mos jetë dënuar penalisht me vendim gjykate të formës së prerë.

Në vlerësim do të kenë prioritet kandidatët që kanë qenë pjesë e forcave të armatosura ose që kanë shërbyer në policinë e shtetit.

STAF CIVIL

Pozicioni

Arsimi

Vende vakante

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Përgjegjës Sektori	I Lartë	1
Specialist Inxhinieri	Inxhinieri	1
Sekretar/protokollist/operator	I Lartë	1
Elektromekanik		5
Shofer		1
Magaziniere		1
Sanitar		1

Sektori Ligjor

Përgjegjës i Sektorit Ligjor	Juridik	1
Specialist i Sektorit Ligjor	Juridik	2
Kartelist	I Lartë	2

Sektori i Çështjeve Shoqërore

Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Shoqërore	Shkenca Sociale	1
Specialist (Edukator)	Shkenca Sociale	2
Specialist (P. Social, Psikolog)	Shkenca Sociale	5
Specialist (bibliotekë)	Gjuhë-Letërsi	1

Sektori i Financës dhe Buxhetit

Specialist Finance	Ekonomik	1
Specialist Buxheti	Ekonomik	1

Sektori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor

Përgjegjës i Sektorit Shëndetësor	Mjekësi	1
Specialist Mjek	Mjekësi	1
Mjek Stomatolog	Stomatologji	1
Kryeinfermier	Infermieri	1
Infermier	Infermieri	9
Farmacist	Farmacit	1
Kujdestar	I mesëm	3
Sanitar në Regjimin e Brendshëm	I mesëm	3

Sektori Logjistik

Përgjegjës i Sektorit	Ekonomik ose Ushtarak	1
Specialist		1
Kuzhinier		4
Punëtor Mirëmbajtës		1

Kandidatët për Punonjës Civil në IEVP duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme si vijon si dhe kriteret e posaçme të parashikuara në Urdhrin nr. 6783 datë 13/11/2017 bashkëlidhur:

- të jetë shtetas shqiptar;
- ka zotësi të plotë për të vepruar;
- është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht, për të kryer detyrën;
- nuk është dënua penalisht me vendim gjykatë të formës së prerë.

Personeli shëndetësor, përveç diplomës, duhet të jetë i pajisur edhe me lejen e ushtrimit të profesionit.

1. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

1. Kandidatët që aplikojnë për pozicionet e mësipërme duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- [Kërkesën që specifikon pozicion për të cilin po aplikohet;](#)
- [Jetëshkrimi i plotësuar;](#)
- Fotokopje e diplomës së arsimit përkatës dhe listës së notave;
- Fotokopje e kartës së identitetit ose e pasaportës;
- [Formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që ushtrojnë funksione publike, të plotësuar elektronikisht dhe të nënshkruar, sipas linkut](#)
- Dy referenca nga punëdhënës të mëparshëm;
- [Autorizimin me shkrim për të lejuar Ministrinë e Drejtësisë të bëjë verifikimin e gjendjes gjyqësore;](#)
- [Deklaratën që kandidati nuk është në kushtet e konfliktit të interesit;](#)

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen elektronikisht pranë sekretariatit të ngritur për këtë qëllim në Ministrinë e Drejtësisë, në adresën e-mail: info@dpbsh.gov.al ose me postë në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Rruga "Zef Serembe", ish BRMR (Brigada e Mbështetjes Rajonale), Tiranë.

Vlerësimi i mëtejshëm i kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme do të bëhet nëpërmjet kriterëve të konkurrimit që do të përcaktohen nga Ministria e Drejtësisë.

Afati i dorëzimit të aplikimeve: 28 Nëntor 2017

Kandidatët do të njoftohen nëpërmjet postës elektronike për informacione në lidhje me plotësimin e kriterëve, dhe procedurën e konkurrimit dhe vlerësimit.

Më shumë informacion mund të gjeni në faqen internet të Ministrisë së Drejtësisë www.drejtesia.gov.al

